



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.898/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Gillogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Elvire Sejdiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Elvire Sejdiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Klinë nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Klinë në fshatin Qabiq, në Qendrat e Votimit QV nr. 0812C/01R, 0807C/01R, 0807C/02R, 0807C/03R, 0811C/02R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutin e Qendrave të Votimit si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Elvire Sejdiu, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Klinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Klinë, me të cilën pretendon se në fshatin Qabiq në Qendrën e Votimit QV nr. 0812C/01R, 0807C/01R, 0807C/03R, 0811C/02R, janë bërë pa rregullsi dhe gabime lidhur me plotësimin e votave në Formularin e kandidatëve nga radhët e subjektit politik PDK.

Në cilësi të provave si dëshmi apelit i ka bashkangjitur deklaratat e votuesve .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshëm të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ne apel janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit te provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka pa rregullsi dhe gabime me rastin e publikimit të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, siç rezulton edhe nga pretendimet në apel nga vetë pala apeluese, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidaten nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Qendrat e Votimit të cekura më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura, prandaj Paneli e vlerësoj sit ë bazuar apelin e apeluesit dhe në mbështetje të neneve 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha më sipër duke u bazuar në mbështetje te nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.898/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.